



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:295890

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644475

KE.nr.2585/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësve: 1.NPT “Valton Impex”, me NRB: 80039352, me seli në Podujevë; 2. NPT “Valtoni Com”, me NRB: 810440933 me seli në Podujevë; 3. NPT “Ismiri”, me NUI:810780040 me seli në Podujevë dhe 4. NPPT “Besiana”, me NRB: 80105118 me seli në Podujevë, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati Hasan Rexha, ndërsa paditësi i dytë përfaqësohet edhe nga avokati Jeton Osmani nga Prishtina, kundër të paditurit ProCredit Bank SH.A., me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Kërveshi & Partners”, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 136.252.18 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 25.04.2024, në prani të autorizuarve të palëve paditëse dhe të autorizuarës së palës së paditur, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve: 1.NPT “Valton Impex”; 2. NPT “Valtoni Com”; 3. NPT “Ismiri”, dhe 4. NPPT “Besiana”, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri ProCredit Bank SH.A., që për shkak të ekzekutimit të padrejtë të garancionit nr.10-30-224-1602 në ngarkesë të mjeteve të paditësve, me të cilën u është pamundësuar përmbushja e rregullt e detyrimeve sipas kredisë nr. A-38156 për zhvillimin e biznesit dhe janë ndëshkuar nga Banka Qendrore e Kosovës me shenjë “W” (borxhlinjë të qjinjë), paditësve t’ua paguaj shumat si në vijim:
  - i. Paditësit 1. NPT “Valton Impex”, në emër të dëmit material në formën e fitimit të humbur për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, të ia

paguaj shumën prej 35,842.70 €, si dhe në emër të dëmit jo material për shkak të dëmtimit të imazhit dhe denigrimit të reputacionit shumën prej 54,000.00 €;

- ii. Paditësit: 2. NPT “Valtoni Com”, në emër të dëmit material në formën e fitimit të humbur për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, të ia paguaj shumën prej 8,609.48 €, si dhe në emër të dëmit jo material për shkak të dëmtimit të imazhit dhe denigrimit të reputacionit shumën prej 27,000.00 €;
  - iii. Paditësit: 3. NPT “Ismiri”, në emër të dëmit jo material për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit, të ia paguaj shumën prej 5,400.00 €, si dhe
  - iv. Paditësit: 4. NPPT “Besiana”, në emër të dëmit jo material për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit të ia paguaj shumën prej 5,400.00 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 01.11.2022 e deri në pagesën definitive.
- II. DETYROHEN paditësit që në mënyrë solidare, të ia paguajnë të paditurit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 4,535.50 €. (katërmijë e pesëqind e tridhjetë e pesë euro e pesëdhjetë cent) në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Paditësit: 1.NPT “Valton Impex”; 2. NPT “Valtoni Com”; 3. NPT “Ismiri” dhe 4. NPPT “Besiana”, me datën 03.11.2014 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, kanë paraqitur padi për kompensim të dëmit, kundër të paditurit ProCredit Bank SH.A., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri ProCredit Bank SH.A., që paditësve që nga data 01.09.2007 të iu paguaj shumën mujore prej 11,850.00 € për secilin veç e veç, deri në tërheqjen e tyre nga kategorizimi i Bankës Qendrore të Kosovës dhe nga regjistri i kreditoreve të Kosovës si borxhlinj të kqinjë, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin IV. C.nr. 555/14 të datës 20.02.2017, me pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve “Valoni Impex”, NPT “Besiana Comerc”, NPT “Ismiri”, NPT “Valtoni-Com”, kundër të paditurit “ProCredit Bank SH.A.”, pasi që kërkesa është parashkruar. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që paditësit të ia paguajnë të paditurit shumën prej 2,202.00 €, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës së paditësve, me aktvendimin Ae.nr.134/17, të datës 09.12.2019, e ka aprovuar ankesën e paditësve dhe e ka prishur Aktgjykimin IV. C.nr. 555/14 të datës 20.02.2017, të gjykatës së shkallës së parë, dhe të njëjtën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, duke marr numrin e ri IV.Ek.nr 792/19, ndërsa pas transferimit të lëndës në Gjykatën Komerciale, e njëjta ka marr numrin e ri KE.nr. 2585/22.

Paditësit përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre, avokatit Hasan Rexha, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se mbeten pranë kërkesëpadisë së precizuar, duke theksuar se e paditura me ekzekutimin e padrejtë të garancionit numër 10-30-224-1602, i ka ngarkuar paditësit me gjendje minus të llogarive ku si pasojë paditësve i është pamundësuar përmbushja e rregullt e detyrimeve të kredisë nr. A-38156, e cila i ishte lejuar për zhvillimin e biznesit. Kanë shtuar që kjo ka ndodhur pa dijeninë e paditësve dhe pa bazë ligjore duke theksuar që si pasojë e këtyre veprimeve të një anshme të të paditurit dhe në kundërshtim me ligjin, paditësit janë ndëshkuar nga Banka Qendrore e Kosovës me shenjë “W” si debitorë të qinjë, duke iu pamundësuar paditësve realizimi i kredive të tjera, pjesëmarrja në tenderë, lidhja e kontratave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimin e afarizmit me subjektet e tyre.

Më tutje kanë theksuar që në rastin konkret paditësve i është shkaktuar dëm material dhe jo material si rezultat i veprimeve pa bazë ligjore nga e paditura, andaj edhe të njëjtëve ju takon dëmi në formën e fitimit të humbur si dhe dëmi jo material në emër të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit të tyre. Sa i përket pretendimit të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesave të paditësve, kanë theksuar që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me pagesa periodike por me dëmin e shkaktuar i cili është duke vazhduar edhe tani dhe pavarësisht kësaj kjo po ashtu përbën çështje të gjykuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit NTP “Valton Com”, avokati Jeton Osmani, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar që mbetet në tërësi pranë të gjitha deklaramëve të deri tanishme duke shtuar se nga provat e administruara vërtetohet pa mëdyshje baza juridike e kërkesëpadisë dhe gjithashtu edhe lartësia e saj. Sa i përket bazës juridike ka theksuar që nuk është kontestuese se e paditura e ka vendosur paditësin NTP “Valton Com”, së bashku me paditësit e tjerë në kategorinë “W”, në historinë e klasifikimeve pranë BQK-së, mbi bazën e një ekzekutimi të gabuar të garancionit bankar të cilit i kishte skaduar afati, e për çka e paditura mban barrën e kompensimit të dëmit edhe sipas LMD-së, e po ashtu edhe në bazë të rregulloreve të BQK-së, që rregullojnë klasifikimin e borxhlinjve të kqinjë.

Ka shtuar që në rastin konkret e paditura i ka raportuar gabimisht paditësit tek BQK, si “borxhlinjtë të kqinjë” me çka të njëjtit i ka dëmtuar si në emrin e tyre ashtu edhe në formën e fitimit të munguar gjë që është vërtetuar edhe nga ekspertiza financiare.

Sa i përket parashkrimit të deklaruar nga e paditura, ka theksuar që një pretendim i tillë nuk qëndron, sepse e paditura përveç lajmërimit të parë që e ka bërë në vitin 2011, e njëjta i ka përsëritur këto gabime edhe gjatë vitit 2013 në tri raste, si dhe në vitin 2017 gjë e cila vërtetohet nga raporti i detajuar i kreditorit i dorëzuar pranë kësaj gjykate në raport me paditësin. Për më tepër dëmi në emrin afarist dhe dëmi tjetër i vërtetuar nga provat e administruara vazhdon edhe më tutje pasi që ky klasifikim nuk fshihet nga regjistrat e BQK-së, me ç’rast paditësit i pamundësohet çdo aplikim për kredi si dhe i rritet rrezikshmëria që kërkohet nga bankat, për sigurimin që mjetet e dhëna me kredi do të kthehen, gjë e cila përben edhe denigrim të emrit afarist dhe i shkakton dëm jo material gjatë gjithë kohës paditësve edhe në ditët e sotme.

I kanë propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: 1.NPT “Valton Impex”; 2. NPT “Valtoni Com”; 3. NPT “Ismiri”, dhe 4. NPPT “Besiana”, dhe të detyrohet i padituri ProCredit Bank SH.A., që për shkak të ekzekutimit të padrejtë të Garancionit nr. 10-30-224-1602, në ngarkesë të mjeteve të paditësve, duke i ngarkuar të njëjtit me gjendjen minus të llogarive, e cila për pasojë paditësve ua ka pamundësuar përmbushjen e rregullt të detyrimeve sipas kredisë nr. A-38156, për zhvillim biznesi, ku pastaj BQK i ka ndëshkuar paditësit me shenjën “W”, (borxhlinjë të kqinjë), me ç’rast paditësve ua ka pamundësuar afarizmin (lidhje të kontratave vendore dhe ndërkombëtare, pjesëmarrje në Tender,

marrje të kredive), duke ju shkaktuar dëm material dhe jo material, duke kërkuar që e paditura të ua kompensoj paditësve shumat si në vijim:

Paditësit NPT “Valton Impex”, për dëmin material në formën e fitimit të humbur për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, të ia paguaj shumën prej 35,842.70 €, si dhe në emër të dëmit jo material për periudhën e njëjtë kohore për shkak të dëmtimit të imazhit dhe denigrimit të reputacionit shumën prej 54,000.00 €; paditësit 2. NPT “Valtoni Com”, në emër të dëmit material në formën e fitimit të humbur për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, të ia paguaj shumën prej 8,609.48 €, si dhe për dëmin jo material për periudhën e njëjtë kohore për shkak të dëmtimit të imazhit dhe denigrimit të reputacionit shumën prej 27,000.00 €; paditësit 3. NPT “Ismiri”, në emër të dëmit jo material për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit të ia paguaj shumën prej 5,400.00 € si dhe paditësit 4. NPPT “Besiana” në emër të dëmit jo material për periudhën kohore prej datës 01.11.2011 deri me datën 01.11.2022, për shkak të dëmtimit të imazhit dhe reputacionit të ia paguaj shumën prej 5,400.00 €, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 01.11.2022 e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës kontestimore në emër të përfaqësimit për të gjithë paditësit avokati Hasan Rexha i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në shumën e përgjithshme prej 9,301.82 €, ndërsa avokati Jeton Osmani, në emër të përfaqësimit për paditësin NPT “Valton Com”, shpenzimet i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në shumën e përgjithshme prej 540 €.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarës së tij, avokates Fatjana Shabanaj, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Ka theksuar se paditësit kanë lidhur kontratën mbi hua në shtator të vitit 2007, ndërsa kanë paguar vetëm dy këste të kredisë duke rënë në vonesë që nga viti 2008. Ndërsa për dëmin të cilin paditësit e pretendojnë se i është shkaktuar që nga vitit 2009, është dëshmuar se të njëjtit kanë qenë në dijeni për dëmin e pretenduar që nga viti 2009, gjë e cila është vërtetuar edhe nga raporti i BQK-së, i lëshuar me datën 14.02.2011, ndërsa të njëjtit padinë e kanë paraqitur me datën 03.11.2014, pas 3 viteve e 8 muajve.

Më tutje e paditura ka theksuar që me nenin 361 të LMD-së (1978) i cili ka qenë në fuqi në kohën kur palët kanë pas marrëveshje, rezulton se afati i paditësve për të kërkuar përmbushjen e detyrimit nga e paditura ka filluar që nga viti 2007, ndërsa padia e paditësve është paraqitur në vitin 2014, pra pas kalimit të afatit objektiv dhe subjektiv të parashkrimit, përkatësisht pas kalimit të afatit 3 dhe 5 vjeçar.

Sa i përket pagesës së garancionit në emër të paditësit “Valoni Impex”, ka theksuar që paditësi kishte aplikuar tek e paditura me qëllim të zhvillimit të afarizmit biznesor me kompaninë kroate “Den Breven”, ndërsa paditësi pasi ka dështuar që të bëjë pagesën në mënyrë vullnetare, e paditura ka marr kërkesë nga Raiffeisen Bank që të bëhet pagesa e garancionit për shkak të borxhit të paditësit të parë. Meqenëse përfituesi i garancionit, paditësi Valtoni Impex nuk kishte përmbushur në tërësi obligimet sipas marrëveshjes, i njëjti kishte hyrë në mbitërheqje pranë të paditurit, si dhe në ndërkohë kishte aplikuar për kredi pranë të paditurit, me ç’rast edhe ishte lidhur marrëveshja për kredinë, sipas numrit A-38156 e datës 03.09.2007, në vlerën prej 43,458,78 €, me afat të kthimit për periudhë 36 mujore, ku si bashke huamarrës kishte qenë I.Sh. dhe garantues Ajfer Fetahu.

Më tutje i padituri ka theksuar që pas transferimit të kredisë në xhirollogarinë e paditësit “Valtoni Impex”, në shumën prej 43,458,78 €, meqenëse xhirollogaria e paditësit ishte në mbitërheqje (overdraft) në shumën prej 41,508.38 €, në mënyrë automatike nga llogaria e paditësit, në emër të kthimit të mbitërheqjes, janë marr mjetet për përmbushjen e detyrimit sipas overdraftit dhe të njëjtit në xhirollogari i kishte mbetur shuma prej 1,950.40 €.

Sa i përket pretendimit të paditësit se kredia ka qenë e destinuar për qëllime tjera dhe jo për mbylljen e overdraftit, ka theksuar që kredia e lëshuar ka arritur qëllimin për të cilin është lëshuar, përkatësisht për zhvillimin e biznesit afarist, duke shtuar që asnjë biznes nuk mund të afrohet me gjendje negative në xhirollogari bankare, andaj edhe mbyllja e overdraftit ka arritur qëllimin e zhvillimit të afarizmit të paditësit.

Sa i përket paditësve NTP “Ismiri” dhe NTP Besiana” ka deklaruar që edhe nga ekspertiza financiare është provuar se këto dy biznese nuk kanë pësuar dëm material të cilin e kanë pretenduar me kërkesëpadi, duke shtuar që paditësja NTP “Ismiri”, është themeluar në vitin 2010, pra 3 vite pasi që paditësit dhe e paditura kanë lidhur marrëveshje për garancion dhe për kredi.

Në fund ka theksuar që e paditura ka vepruar konform rregulloreve në fuqi të BQK-së, dhe me rastin e rënies në vonesë të pagesës së kredisë nga ana e paditësit Valtoni Impex, e paditura ka qenë e obliguar që ta njoftoj BQK-në, pasi që mos raportimi në lidhje lejimin e kredive ndaj klientëve paraqet shkelje të rregullave të BQK-së.

I ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar në shumën prej 6,695.00 €.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Ekspertizën financiare të hartuar nga ekspertit R.B., e punuar më datë 20.10.2022; Kërkesa për ndalimin e fletë garancionit nr. L/G2154, e datës 10.09.06; Njoftimi i datës 20.04.2006 i paditësit “Valtoni Impex”; Kërkesa e datës 07.05.2006 e paditësit “Valtoni Impex”; Pasqyra e llogarisë për numrin e llogarisë 1110010133000128-20, e datës 29.11.2007; Zapisnik i datës 13.06.2006; Zahtev za odobrenje “Valtoni Impex”, i datës 10.05.06; Zapisnik, i datës 06.05.06; Zahktiev, i datës 20.04.06; Aktgjykimi C.nr.147/08, i datës 12.05.2014, i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë; Urdhër pagesa e datës 15.09.2006, e lëshuar nga Banka Ekonomike SH.A. –Prishtinë; Garancioni me nr 10-30224-1602; pasqyra e llogarisë për numrin e llogarisë ....., e datës 17.11.2009; Aplikacioni për lëshimin e letër garancionit për numrin e llogarisë ....., Kërkesa e paditësve e datës 11.09.2014 drejtuar BQK-së me nr.Prot.1449; Kërkesa për çregjistrim – fshirje të intabulacionit – shënimit hipotekar të rendit të parë, e datës 04.09.2007; Aktvendimi mbi lirimin (shuarjen e hipotekës), të datës 04.09.2007; Aktvendimi mbi regjistrimin e hipotekës nr.Prot.666/07, i datës 23.07.07; Marrëveshja mbi kredinë A-38156, e datës 03.09.2007 si dhe plani i pagesave; Fatura nr.REF.06/013, e datës 09.06.2013; Raporti kreditor i klientit I.Sh., i datës 18.08.2022, i lëshuar nga BQK si dhe raporti i detajuar kreditor i klientit NPT “Valtoni Impex”, i datës 01.09.2022.

Gjykata duke vlerësuar pretendimet e të paditurit lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësve, pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 376 të LMD-së (1978), ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është parashkruar.

Sipas nenit 376 par.1 të LMD-së, përcaktohet se: “ *Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet prë tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për*

*përsonin që e ka bërë dëmin*". Ndërsa me par.2 të këtij neni përcaktohet se: "*Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi*".

Në rastin konkret duke marr për bazë faktin që paditësit padinë për kompensim të dëmit, e kanë paraqitur me datën 03.11.2014, ndërsa dëmi i pretenduar nga ana e paditësve është shkaktuar me datën 14.02.2011, duke llogaritur afatin e parashkrimit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar, rezulton se kërkesa e paditësve është e parashkruar në kuptim të nenit 376 të LMD-së, meqenëse nga momenti kur paditësit kanë mësuar për dëmin e shkaktuar e deri tek paraqitja e padisë kanë kaluar mbi 3 (tri) vite e 8 (tetë) muaj.

Gjykata i shqyrtoi edhe provat tjera të administruara, mirëpo meqenëse kërkesëpadia e paditësve është parashkruar, vlerësoi se provat tjera të administruara janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësve, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë: për përgjigje në padi shumën prej 208 €, për përfaqësim në 7 seanca të mbajtura në procedurën e evidentuar sipas numrit IV.C.Nr 554/14, në shumën prej 1890 € (270,00 € x 7), për përfaqësim në një seancë në procedurën e evidentuar sipas numrit IV.Ek.nr 792/19 në shumën prej 422.50 €; për përfaqësim në katër seanca në procedurën e evidentuar sipas numrit KE.nr 2585/22 shumën prej 1690 € (422.50 € x 4), si dhe në emër të përpilimit të përgjigjes në ankesë shumën prej 325 €, gjithsej shumën totale prej 4,535.50 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2585/22, datë 25.04.2024

Gjyqtari



Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.